



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E Hënë, 12 Janar 2015

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 59, datë 23.12.2014

Me objekt: 1. Interpretimin e neneve 65/1 dhe 78/2 të Kushtetutës.

2. Konstatimin e pavlefshmërisë së mbledhjes së përgjithshme të deputetëve (seancës plenare) të datës 20.2.2014, të thirrur në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe në shkelje të rregullave procedurale që garantojnë një proces të rregullt ligjor, lidhur me këto çështje:

a) vendimin e Kuvendit nr. 12/2014 “Për shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr. 1/2013 të Kuvendit “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”;

b) vendimin e Kuvendit nr. 13/2014 “Për mosmiratimin e propozimit të Presidentit të Republikës me dekretin nr. 7928, datë 16.1.2013 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”;

c) vendimin e Kuvendit nr. 14/2014 “Për zgjedhjen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.....

12599

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 60, datë 29.12.2014

Me objekt 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror (Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit).

2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akte që bëhen shkak për lindje të konfliktit, i vendimit nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës”;

3. Pezullimi i vendimit nr. 3, datë 18.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.....

12605

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Power elektrik Sllabinje” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12613
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hidropower elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12614
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 1.12..2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hidropower elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12614
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12615
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12616
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12616
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Perrollaj”.....	15617
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 1.12. 2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12618
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për HEC “Perrollaj” si burim i rinovueshëm energjie.....	12618
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Dragobia energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Ceremi” dhe “Dragobia”.....	12619
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr.125, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Dragobia energy”sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12620
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 1.12. 2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Future Energy AL” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12621
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 127, datë 1.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Future Energy AL ”sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	12622
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 1.12.2014	Për licencimin e shoqërisë “Axpo Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12622
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 3.12.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Dragobia energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12623

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 3.12.2014	Mbi procedurat për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., (OSSHE sh.a.).....	12624
	Vendim <i>i shkurtuar</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Klement Metushi.....	12624
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Lefter Beqari....	12624
	Korrigjim gabimi	12625
	Korrigjim gabimi.....	12625



VENDIM
Nr. 59, datë 23.12.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 10.6.2014 dhe 26.6.2014, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Oerd Bylykbashi, Ivi Kaso, Gazment Bardhi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Albana Shtylla dhe Alban Brati, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Interpretimin e neneve 65/1 dhe 78/2 të Kushtetutës.

2. Konstatimin e pavlefshmërisë së mbledhjes së përgjithshme të deputetëve (seancës plenare) të datës 20.2.2014, të thirrur në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe në shkelje të rregullave procedurale që garantojnë një proces të rregullt ligjor, lidhur me këto çështje:

a) vendimin e Kuvendit nr. 12/2014 “Për shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr. 1/2013 të Kuvendit “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”;

b) vendimin e Kuvendit nr. 13/2014 “Për mosmiratimin e propozimit të Presidentit të Republikës me dekretin nr. 7928, datë 16.1.2013 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”;

c) vendimin e Kuvendit nr. 14/2014 “Për zgjedhjen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.

BAZA LIGJORE: Nenet 1-4, 42, 65, 73, 75/2, 78/2 dhe 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, përfaqësuesit e kërkuarit, që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 21.10.2013, një grup i nëpunësve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë ILDKPKI) i janë drejtuar Kryetarit të Kuvendit me një petition ku parashtronin shqetësimin e tyre për raste të shkeljes së ligjit nga ana e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së dhe në përfundim kërkonin marrjen e masave nga Kuvendi për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë pranë institucionit të tyre.

2. Në datë 11.11.2013, me propozim të kryetarit të Komisionit të Ligjeve, pranë Kuvendit të Shqipërisë, shumica e anëtarëve të këtij Komisioni miratoi vendimin nr. 1, datë 11.11.2013, me anë të të cilit vendosi: “*Ngritjen e një grupi pune për të kontrolluar veprimtarinë e ILDKPKI për verifikimin e përmbushjes së detyrave funksionale nga ana e institucionit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e ILDKPKI-së”.*”

3. Në datën 24.1.2014, Komisioni i Ligjeve, me shumicë votash, miratoi raportin e grupit të punës për kontrollin e veprimtarisë së ILDKPKI-së, duke i propozuar njëkohësisht Kuvendit konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të emërimit në detyrë dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në bazë të neneve 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), sipas konkluzioneve të raportit.

4. Në datën 13.2.2014, 1/3 e deputetëve bënë kërkesë për shkarkimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, bazuar në nenin 115 të Rregullores së Kuvendit. Kërkesa u



paraqit në Komisionin e Ligjeve në datën 14.2.2014. Në datën 18.2.2014, Komisioni i Ligjeve rimiratoi kërkesën me shkrim dhe i ripropozoi seancës plenare konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit dhe lirim nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

5. Në datën 20.2.2014, Kuvendi i Shqipërisë, në seancë plenare, përfshiu në rendin e ditës këtë çështje dhe votoi lirim nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, si dhe emërimin e kandidaturës tjetër të dekretuar nga Presidenti i Republikës më parë për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

II

Parashtrimet e palëve

6. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të interpretuar nenet 65/1 dhe 78/2 të Kushtetutës lidhur me dy koncepte: A mundet Kuvendi të rimarrë në shqyrtim vendime të natyrës politiko-administrative përtej mandatit 4-vjeçar? Cilat janë rrethanat kur mbledhja e deputetëve konsiderohet e zhvilluar në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit dhe deri ku shtrihen efektet e saj? Kërkuesi, gjithashtu, në përfundim të interpretimit për këto dispozita, kërkon nga Gjykata edhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të Kuvendit të marra gjatë procesit parlamentar, në përfundim të të cilit u vendos liri nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në funksion të këtij kërkimi, ai paraqet si argument se seanca plenare është thirrur në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit, duke zhvilluar në këtë mënyrë një proces të parregullt ligjor.

7. Kërkuesi paraqet si argumente lidhur me kërkimet e tij si më poshtë:

a) Është cenuar neni 65/1 i Kushtetutës, pasi Kuvendi ka marrë tagrin të rivendosë për një çështje që është vendosur në një legjislaturë të mëparshme, duke tejkaluar afatin kohor gjatë të cilit Kuvendi ushtron mandatin e tij, gjë që bie ndesh me parimin e zgjedhjeve periodike të sanksionuar në Kushtetutë.

b) Është cenuar rregullorja e Kuvendit, pasi dekreti i Presidentit për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së ndaj të cilit ishte shprehur më parë vullneti, nuk mund të rivotohej

sërisht. Në asnjë rast nuk mund të shprehet Kuvendi më shumë se një herë për një akt. Dekreti i Presidentit të Republikës ishte shqyrtuar një herë dhe për të ishte shprehur vullneti i Kuvendit, prandaj ai nuk mund të ishte më objekt rivotimi në Kuvend.

c) Janë cenuar nenet 75/2 dhe 78/1 të Kushtetutës, ku parashikohet funksionimi i Kuvendit sipas rregullores së tij dhe se mbledhja e deputetëve që mbahet pa u thirrur sipas kësaj rregulloreje nuk sjell asnjë pasojë, referuar nenit 78/2 të Kushtetutës.

ç) Seanca e Kuvendit është thirrur jashtë rendit të ditës. Nga procesverbalet e mbledhjes së Komisionit të Ligjeve rezulton se kjo çështje nuk është përfshirë në programin e punës dhe në kalendarin e punimeve të atij komisioni. Relacioni i relatorit të komisionit nuk i është vënë në dispozicion deputetëve 3 ditë përpara seancës, sipas nenit 38/2 të rregullores. Gjithashtu, relacioni i komisionit nuk është miratuar me shumicën e nevojshme të votave.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

a) Kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, pasi nuk ka asnjë qëndrim të kundërt midis shumicës dhe pakicës parlamentare. Nga praktika e vetë Gjykatës Kushtetuese rezulton se norma që duhet të interpretohet duhet të jetë e paqartë, ekuivoqe dhe kontradiktore dhe si rrjedhojë e saj të ketë lindur një mosmarrëveshje kushtetuese midis palëve në gjykim. Gjithashtu, kërkuesi nuk legjitimohet as për kërkimet e tij lidhur me procesin e parregullt ligjor të zhvilluar, sipas tij, nga Kuvendi, pasi nuk i njihet kjo e drejtë nga Kushtetuta.

b) Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion të shqyrtojë kushtetutshmërinë e një akti individual, siç është ai i shkarkimit nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Akti i shkarkimit të Inspektorit të Përgjithshëm është akt individual administrativ dhe si i tillë ai duhet të kundërshtohet në gjykatën administrative. Gjithashtu, rregullorja e Kuvendit nuk është akt me natyrë kushtetuese, pasi shërben për rregullimin e brendshëm të Kuvendit. Është në diskrecionin e këtij të fundit të interpretojë dispozitat e rregullores dhe mënyra e



interpretimit të saj nuk mund të jetë objekt kontrolli nga Gjykata Kushtetuese.

c) Pretendimet për themelin e kërkesës nuk qëndrojnë, pasi, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kryetari i Kuvendit, bazuar në nenin 26/7 të rregullores, e ka futur kërkesën për shkarkim të Inspektorit të Përgjithshëm automatikisht në programin e punës së Kuvendit. Sa i takon dhe pretendimit lidhur me njoftimin paraprak të deputetëve për çështjen që do diskutohet ai nuk qëndron, pasi neni 38/1 i rregullores ku kërkuesi e mbështet kërkesën aplikohet vetëm për projektligjet dhe jo për kërkesat për shkarkim të funksionarëve, siç është dhe rasti konkret.

ç) Gjithashtu, edhe pretendimi lidhur me pavlefshmërinë e vendimmarrjes së Kuvendit si shkak i mosvotimit të tij nga numri i nevojshëm i deputetëve nuk qëndron, pasi numri i anëtarëve të pranishëm për vendimmarrje ka qenë ai i duhuri. Dy deputetët e verifikuar si të pranishëm në sallën e mbledhjes së komisionit në momentin e votimit por që nuk morën pjesë në votim u llogaritën për efekt të arritjes së kuorumit të numrit të nevojshëm për vlefshmërinë e zhvillimit të procedurave të vendimmarrjes, në përputhje me interpretimin e bërë në vendimin nr. 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese për vlefshmërinë e votimit në Kuvend.

d) Sa i takon pretendimit për mosfutjen në kalendarin e punimeve të çështjes së shkarkimit të Inspektorit të Përgjithshëm ai është i pabazuar, pasi Kryetari i Kuvendit ka ushtruar kompetencën që i jep neni 116 i rregullores, sipas të cilit, kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të seancës sa i takon interpretimit dhe zbatimit të rregullores, është kompetencë e drejtuesit të seancës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Mbi legjitimitetin e kërkuarit

9. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë (më poshtë Kuvendi), në seancë prapësoi se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në rrugën e interpretimit të normave kushtetuese nëse nuk ka një konflikt konkret për mënyrën e interpretimit të tyre nga organet që marrin pjesë në gjykim.

10. Gjykata rithekson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 134/1, ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të paragrafit 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në pikat “a” “b”, “c”, “ç” të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo, në mënyrë të vazhdueshme, ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 18, datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kushtetuta, në nenin 124 të saj, parashikon se Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Gjykata, në praktikën e vazhdueshme të saj, ka vlerësuar se ushtrimi i kompetencës së interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese kërkon plotësimin e kushteve si vijon: *Së pari*, norma që kërkohet të



interpretohet duhet të jetë e paqartë dhe si pasojë e kësaj paqartësie që ajo mbart dhe kuptimit që i është dhënë ka lindur një “problem / mosmarrëveshje kushtetues/e. *Së dyti*, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetent, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të padrejtë të kësaj norme kushtetuese. *Së treti*, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar (*shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011, nr. 24, 09.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 59, datë 1.4.2014 të mbledhjes së gjyqtarëve*).

13. Nga sa më lart, rezulton se Gjykata bën interpretimin e normës kushtetuese vetëm nëse vlerëson se gjendet para një “*problemi kushtetues*” dhe synon zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Nëse do të pranoni një interpretim *ad contrarium*, Gjykata do të gjendej para një situatë ku produkte të interpretimit do të ishin opinione për mënyrën se si duhet të sillen në të ardhmen institucionet shtetërore ose do të përfundonte duke ushtruar një kontroll *ex ante* të veprimtarisë së këtyre institucioneve, pa pasur një mosmarrëveshje konkrete (*shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kur një grup deputetësh vë në lëvizje Gjykatën për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës duhet të pretendojë dhe të argumentojë se ka më shumë se një interpretim ose zbatim të ndryshëm të Kushtetutës dhe se nga ky fakt kanë ardhur pasoja të tilla që të kenë shkaktuar nevojën për një interpretim përfundimtar të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 25, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata konstaton se kërkuesi në kërkesën e tij paraqitur kësaj Gjykate, si dhe gjatë seancës gjyqësore nuk paraqiti argumente kushtetuese të mjaftueshme lidhur me legjitimitetin e tij për interpretimin e dispozitave kushtetuese sipas objektit. Ai u përqendrua vetëm në faktin se

Kuvendi duke vendosur mbi një çështje të shqyrtuar më parë prej tij ka dalë tej mandatit të tij 4-vjeçar, parashikuar nga neni 65/1 i Kushtetutës për shkak se për aktin konkret vullneti ishte shprehur nga Kuvendi në një mandat të mëparshëm.

16. Neni 65/1 i Kushtetutës parashikon: “*Kuvendi zgjidhet çdo katër vjet.*” Neni 78/2 i Kushtetutës parashikon: “*Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.*” Në çështjen konkrete për gjykim, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me 2 pyetje: së pari, nëse Kuvendi mundet të shqyrtojë tej mandatit 4-vjeçar vendime të natyrës politiko-administrative dhe, së dyti, në cilat raste vendimi i Kuvendit mund të quhet i marrë në kundërshtim me rregulloren, duke sjellë dhe pavlefshmërinë e vendimmarrjes, sipas nenit 78/2 të Kushtetutës?

17. Gjykata vlerëson se lidhur me interpretimin e nenit 65/1 të Kushtetutës, gjatë gjykimit nuk u arrit të identifikohet ndonjë mosmarrëveshje ose qëndrim i ndryshëm mbi kuptimin e konceptit të mandatit parlamentar nëse ai zgjat më pak apo më shumë se 4 vjet. Nga kërkuesi nuk u soll argument kushtetues apo qëndrim konkret i ndryshëm nga subjekti i interesuar që të lindnin dyshime lidhur me kohëzgjatjen e mandatit parlamentar apo tendencën për ta zgjatur atë tej afatit 4-vjeçar të parashikuar nga neni 65/1 i Kushtetutës, siç pretendon kërkuesi. Duke qenë se nevoja për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës duhet të lindë nga të paktën dy qëndrime të ndryshme të subjekteve të përfshira në procesin e zbatimit të saj, Gjykata çmon se kërkuesi nuk arriti të justifikojë nevojën për një interpretim përfundimtar të dispozitave kushtetuese.

18. Në çështjen konkrete, kërkuesi nuk paraqiti qëndrime të ndryshme të lidhura me normën kushtetuese që kërkon të interpretohet, por me mënyrën e vendimmarrjes së Kuvendit për një akt individual. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet të kërkojë interpretim të normës kushtetuese, pasi konflikti që ai pretendon se ekziston jo vetëm që nuk vjen nga kuptimi i normës kushtetuese, por kjo normë nuk është e detyrueshme për zbatim në rastin konkret. Kuvendi, në procesin e zhvilluar për shkarkimin e Inspektorit të Përgjithshëm, në



asnjë rast nuk i është referuar nenit 65/1, pasi ai nuk shërben si bazë kushtetuese ose ligjore për procesin e zhvilluar. Në këtë mënyrë, nuk lind nevoja që kjo dispozitë të interpretohet në mënyrë përfundimtare nga kjo Gjykatë, pasi nuk ka lidhje me çështjen konkrete për zgjidhjen e së cilës shërben edhe interpretimi përfundimtar i dispozitave kushtetuese.

19. Kuvendi është organi më i lartë ligjvënës, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit (nenet 1, 64 dhe 65 të Kushtetutës). Pa ekzistencën dhe funksionimin demokratik të Kuvendit, nuk është i mundur realizimi i plotë dhe pa të meta i demokracisë. Pavarësisht se Kushtetuta parashikon edhe ushtrimin e sovranitetit në mënyrë të drejtpërdrejt, dispozitat e mëtejshme të saj e kushtëzojnë atë me kriteret dhe procedura, të cilat jo në çdo rast janë të mundura për t'u aplikuar. Në këtë kuptim, demokracia përfaqësuese është mënyra kryesore e qeverisjes në vend (*vendimi nr. 25, datë 24.9.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

20. Funksionimi i pandërprerë i Kuvendit, madje edhe në rastet kur zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin e ri, është i domosdoshëm dhe jetik për qeverisjen e vendit. Pra, vazhdimësia institucionale formale është e garantuar pikërisht nga neni 65/3 i Kushtetutës, i cili e shtrin mandatin e Kuvendit deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri për të mos lejuar boshllëkun institucional. Pra, mandati i Kuvendit, sipas nenit 65/1 të Kushtetutës, zgjat 4 vjet. Megjithatë ai asnjëherë nuk pushon së ekzistuari si i tillë, pasi edhe kur i ka mbaruar afati 4-vjeçar, ai quhet ende funksional deri ditën që konstituohet Kuvendi i ri. Ky është kuptimi i nenit 65/1, të cilin Gjykata nuk e sheh të lidhur me procesin vendimmarrës që kontestohet nga kërkuesi. Ajo vlerëson se mandati kohor 4-vjeçar i Kuvendit, sipas nenit 65/1, lidhet me përtëritjen e përbërjes së Kuvendit periodikisht një herë në 4 vjet, nëpërmjet zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe jo me llojin e akteve që ai miraton ose shfuqizon.

21. Lidhur me pyetjen e dytë të shtruar nga kërkuesi para Gjykatës, pra cilat janë rrethanat kur mbledhja e deputetëve konsiderohet në kundërshtim me rregulloren dhe deri ku shtrihen efektet e saj, Gjykata çmon se nevoja për interpretim përfundimtar nuk është mjaftueshmërisht e argumentuar në nivel

kushtetues. Gjykata nuk ka funksion të parashikojë në mënyrë shteruese të gjitha rrethanat që e bëjnë një mbledhje të Kuvendit të pavlefshme, pasi një gjë e tillë nuk përputhet me natyrën e saj të gjykimit. Funksioni i Gjykatës është të analizojë konfliktet konkrete dhe jo ato të mundshme ose hipotetike. Vendimmarrja e Gjykatës përqendrohet në situata konkrete dhe jo abstrakte për të konstatuar pavlefshmërinë e mbledhjes së Kuvendit (*shih vendimin nr. 75, datë 19.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nëse Gjykata do të interpretonte këtë dispozitë, atëherë ajo do t'i hynte shqyrtimit faktik të procedurave të ndjekura nga Kuvendi dhe do të zhvillonte një proces vlerësimi të akteve individuale për të arritur në përfundimin nëse procesi para Kuvendit ka qenë apo jo i rregullt, në përputhje me nenin 78/2 të Kushtetutës. Gjykata vlerëson se 1/5 e deputetëve, si subjekt i posaçëm, nuk mund t'i drejtohet asaj në rrugën e pretendimit për një proces të parregullt ligjor, pasi kjo e drejtë i njihet vetëm individit, sipas nenit 134 të Kushtetutës.

23. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij për interpretim përfundimtar të neneve 65/1 dhe 78/2 të Kushtetutës¹.

B. Mbi shpalljen të pavlefshme të vendimeve të Kuvendit për shkarkimin dhe emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së

24. Kërkuesi pretendon se Kuvendi nuk ka respektuar rregulloren lidhur me procesin e votimit në seancë, pasi çështja e shkarkimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nuk ka qenë përfshirë në programin e punës dhe rendin e ditës, ashtu siç e përcakton Rregullorja.

25. Në kërkesën e tij, kërkuesi i referohet edhe procedurave të zhvilluara në komisionin e ligjeve dhe në seancë plenare. Në seancën gjyqësore të zhvilluar para Gjykatës, kërkuesi u përqendrua vetëm në faktin se çështja konkrete nuk ishte futur në rendin e ditës në seancë plenare dhe u tërhoq nga kërkesa për mosfutjen e çështjes në programin e punës së Kuvendit (shih procesverbalin e seancës, f. 6).

¹ Gjyqtarët S. Berberi, V. Tusha, A. Xhoxhaj dhe G. Dizdari votuan për legjitimitimin e kërkuesit lidhur me kërkimin për interpretimin përfundimtar të nenit 78/2 të Kushtetutës.



26. Subjekti i interesuar parashtrori se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë kushtetushmërinë e akteve individuale, pasi për to kompetente është tashmë gjykata administrative. Sipas subjektit të interesuar, para gjykatës administrative është duke u gjykuar tashmë çështja konkrete, e cila është inicuar nga ish-Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

27. Lidhur me shtrirjen e juridiksionit të saj në kontrollin e akteve normative/individuale të organeve qendrore, Gjykata ka theksuar se vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Në një rast Gjykata ka çmuar se vendimi i kundërshtuar nuk përmban tipare të një akti me karakter normativ, pasi nuk vendos norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh (*vendim i mbledhjes së gjyqtarëve nr. 35/2013*).

28. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Gjykata ka theksuar se një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh. Një akt individual i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete, me natyrë teknike dhe jo normative. *Akti individual* është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, ndërsa *akti normativ*, është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga ligji nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

29. Në vlerësimin e Gjykatës, tri kriteret

përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: i) *Subjektet të cilave akti u drejtohet* - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii) *Objekti* - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; iii) *Karakterit shterues/jo shterues* - efektet shtrihen të subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose të subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme (*shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009 dhe vendimin nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në çështjen konkrete, kërkuesi kërkon shpalljen absolutisht të pavlefshme të akteve të Kuvendit të marra, sipas tij, në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit. Aktet, të cilave u referohet kërkuesi, janë: a) vendimi i Kuvendit nr. 12/2014 “Për shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr. 1/2013 të Kuvendit “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”; b) vendimi i Kuvendit nr. 13/2014 “Për mosmiratimin e propozimit të Presidentit të Republikës me dekretin nr. 7928, datë 16.1.2013 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”; c) vendimi i Kuvendit nr. 14/2014 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.

31. Gjykata konstaton se të tria aktet janë akte individuale, që lidhen me procesin e kontrollit dhe më pas të shkarkimit të një funksionari publik, konkretisht të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Si konkluzion, kontrolli kushtetues i këtyre akteve nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por të gjykatave administrative, para së cilës aktualisht po zhvillohet një proces gjyqësor administrativ për kundërshtimin e këtyre akteve nga ish- Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

32. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka legjitimitet t'i drejtohet asaj me kërkesën për të kontrolluar vendimet e Kuvendit që lidhen me këtë proces vendimmarrës të tij.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131, 132 të Kushtetutës, si dhe të neneve 49 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës².

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

Anëtarë pjesërisht kundër: Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari.

VENDIM

Nr. 60, datë 29.12.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “

me sekretare Blerina Cinari, në datën 4.6.2014, mori në shqyrtim, në seancë plenare, çështjen nr. 12 Akti që i përket:

KËRKUES: KOMUNA KASHAR, përfaqësuar me autorizim nga z. Ivi Kaso dhe znj. Majlinda Shehu

KOMUNA FARKË, përfaqësuar me autorizim nga z.Ivi Kaso

² Unanimisht për kërkesën për interpretim të nenit 65/1 dhe shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimeve të Kuvendit për shkarkimin dhe emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI; me shumicë votash për interpretim të nenit 78/2 të Kushtetutës.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT, përfaqësuar me autorizim nga z. Artur Metani dhe znj. Jonida Gaba

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar me autorizim nga z. Engjell Agaci, znj. Majlinda Dhuka dhe z. Artur Metani

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror (Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit).

2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akte që bëhen shkak për lindje të konfliktit, i vendimit nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës”;

3. Pezullimi i vendimit nr. 3, datë 18.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 124/1, 131/ç, dhe 134/1/c të Kushtetutës dhe nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkesës, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) në mbështetje të neneve 3, 6, 8, 18/2, 26 dhe 32 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (ligji për planifikimin e territorit), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 3.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), ka miratuar vendimin nr. 3, datë 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese



në zonat me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës” (vendimi nr. 3/2013). Me anë të këtij vendimi ka vendosur të përcaktojë zonat ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të Kurorës së Tiranës. Në zonat e Kurorës së Tiranës është pezulluar dhënia e të gjitha lejeve zhvillimore nga autoritetet e planifikimit deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, duke lejuar dhënien e lejeve zhvillimore ndërtimore vetëm për dy raste përjashtimore: a) punime mirëmbajtjeje; b) leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar. Vendimi ka përcaktuar institucionet që ngarkohen për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona (pika 4), kurse për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të tij, vendimi ka ngarkuar autoritetet e planifikimit (pika 5).

2. Komuna Kashar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se vendimi nr. 3/2013 ka cenuar nenin 13 të Kushtetutës mbi autonominë vendore dhe decentralizimin, si parimet themelore kushtetuese të funksionimit të pushtetit vendor. Komuna Farkë i është drejtuar Gjykatës me të njëjtat pretendime. Duke qenë se komunat Kashar dhe Farkë (kërkuesi) kanë ngritur të njëjtat pretendime me të njëjtin objekt dhe me të njëjtin shkak si mosmarrëveshje kompetence, Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 18.03.2014 ka vendosur bashkimin e çështjeve në një të vetme.

II

3. **Kërkuesi** pretendon se janë cenuar funksionet e veta të qeverisjes vendore që lidhen me menaxhimin e tokës dhe kontrollin mbi territorin nëpërmjet vendimit të kundërshtuar si shkak konflikti. Për rrjedhojë, nuk është respektuar neni 13 i Kushtetutës, autonomia vendore dhe decentralizimi, si parimet themelore kushtetuese të funksionimit të pushtetit vendor. Më konkretisht, kërkuesi argumenton këto shkelje:

3.1 KKT-ja ka ushtruar disa prej kompetencave të organeve të qeverisjes vendore në fushën e kontrollit mbi territorin, përfshirë të drejtën e pezullimit të zhvillimit në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj vlerave e karakteristikave të caktuara apo funksioneve vendore të objektit ose të zonës.

3.2 Veprimtaria e organeve vendore të

planifikimit, në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës, është bllokuar a priori dhe në mënyrë disproporcionale, duke qenë të varur në ushtrimin e funksioneve të tyre nga një vendimmarrje e organeve të pushtetit qendror (nga heqja e masës së pezullimit).

3.3 Organet e pushtetit qendror (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, AKPT-ja, ALUIZNI dhe INUK-u), janë autorizuar për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e territorit ose rehabilitimin e tij, duke uzurpuar disa prej kompetencave të organeve të pushtetit vendor lidhur me administrimin e territorit nën juridiksionin e tyre.

3.4 Pezullimi nuk është vendosur gjatë nismës për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të çështjes, ashtu siç është parashikuar në nenin 32 të ligjit për planifikimin e territorit.

3.5 Vendimi nr. 3/2013 është marrë në kundërshtim me nenin 64 të ligjit për planifikimin e territorit, pasi afati i pezullimit i vendosur prej tij është i papërcaktuar, ndërkohë që ligji ka parashikuar një afat maksimal pezullimi 12 muaj.

3.6 Pezullimi nuk është përdorur në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë dhe kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin zgjidhje të përshtatshme.

3.7 Edhe pse pezullimi i njihet si kompetencë AKPT-së, në rastin konkret ai është vendosur nga KKT-ja.

4. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, pretendon se:

4.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion, pasi kompetenca pezulluese e KKT-së nuk është kompetencë kushtetuese si kusht për shqyrtimin e çështjes nga gjykata.

4.2 Vendimi nr. 3/2013 është akt individual dhe si i tillë ai nuk i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, por atij administrativ.

4.3 Kërkuesi i ka orientuar kërkimet e tij në formën e një konflikti normativ, pra të krijuar nga ligji për planifikimin e territorit dhe si e tillë kërkesa është e pabazuar.

4.4 Ligji për planifikimin e territorit i jep rëndësi jo vetëm planifikimit, por edhe zhvillimit dhe kontrollit të territorit, prandaj edhe organet



qendrore, si AKPT-ja dhe ministritë e linjës, hartojnë politika e plane territoriale që bëhen instrumente detyruese për territoret vendore. Instrumentet kombëtare kanë përparësi në raport me instrumentet vendore.

4.5 Zhvillimet e mundshme në zonat e prekura nga vendimi nr. 3/2013 do të kishin një impakt të drejtpërdrejtë e të pariparueshëm mbi zonat e rëndësisë së veçantë kombëtare të Kurorës së Tiranës, të cilat janë objekt i planifikimit kombëtar. Emergjencia e ruajtjes dhe rehabilitimit të Kurorës së Tiranës nuk është uzurpim kompetencash, por mbrojtje e interesit publik.

4.6 Vendimi nr. 3/2013, që përcakton pezullimin e lejeve të ndërtimit, është një masë e përkohshme, me afat, dhe si e tillë proporcionale me synimin që kërkon të arrijë.

5. **Subjekti i interesuar, Këshilli Kombëtar i Territorit**, ka paraqitur të njëjtat pretendime me Këshillin e Ministrave.

III

A. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 3/2013 - objekt shqyrtimi.

6. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 3/2013 të KKT-së deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës, me pretendimin se në rastin konkret, pezullimi i dhënies së lejeve të zhvillimit cenon si interesat e organeve vendore, ashtu edhe të individëve. Ai pretendon se vendimi nr. 3/2013, nga njëra anë, i vendos organet e qeverisjes vendore në pamundësi për të përmbushur funksionet e tyre në shërbim të qytetarëve dhe ato nuk arrijnë dot të mbledhin të ardhurat që vijnë nga procesi i zhvillimit të zonave dhe, nga ana tjetër, cenon të drejtat e pronarëve të ligjshëm për të zhvilluar pronat e tyre në përputhje me planet vendore të zhvillimit, në rastet kur organet vendore i kanë të miratuara plane të tilla. Sipas kërkuetit, dëmi i shkaktuar nga zbatimi i këtij akti është i rëndë dhe pothuajse i pamundur për t'u riparuar.

7. Mbledhja e Gjyqtarëve, përpara zhvillimit të seancës plenare, mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 3/2013 - objekt shqyrtimi si shkak i mosmarrëveshjes së kompetencës. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8577/2000), subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet provojë prekjën e interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Mbledhja e Gjyqtarëve nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi. Për këtë arsye, në datën 18.3.2014, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 3/2013.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit

8. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar në nenin 54 të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve apo i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4). Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të po këtij ligji, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton edhe kushtetueshmërinë apo ligjshmërinë e aktit (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka theksuar: “Mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. (...). Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të



bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* dhe duke abstraguar nga rasti konkret. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit”. (...) Bazuar në doktrinën kushtetuese, konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre” (*sib vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Gjykata vëren se KKT-ja është një organ që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe Kryetar i saj është Kryeministri (neni 8 i ligjit për planifikimin e territorit). Pra, vendimi i kundërshtuar i KKT-së është një akt i qeverisjes qendrore. Me vendimin nr. 3/2013, KKT-ja ka vendosur të përcaktojë zonat me rëndësi të veçantë, ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të Kurorës së Tiranës. Në zonat e Kurorës së Tiranës është pezulluar dhënia e të gjitha lejeve zhvillimore nga autoritetet e planifikimit deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, me disa përjashtime. Zonat e Kurorës së Tiranës, referuar hartës bashkëlidhur vendimit nr. 3/2013, konsiderohen komunat Kashar, Paskuqan, Vaqarr, Farkë, Dajt. Komunitat Kashar dhe Farkë, si njësi bazë të qeverisjes vendore, pretendojnë se pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore brenda juridiksionit territorial të tyre, pa asnjë afat dhe pa asnjë kriter, përbën cenim të kompetencave të organeve të qeverisjes vendore, në kundërshtim me parimet e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, të parashikuara në nenin 13 të Kushtetutës. Organet ekzekutive të qeverisjes vendore të këtyre komunave, përkatësisht kryetarët e komunave Kashar dhe Farkë, i janë drejtuar Gjykatës, duke argumentuar se organet vendore janë cenuar në funksionet e veta të qeverisjes vendore, që lidhen me menaxhimin e tokës dhe kontrollin mbi territorin. Për këtë arsye kanë kërkuar edhe shfuqizimin e aktit, objekt të lindjes së konfliktit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se formalisht janë të pranishme elementet e një mosmarrëveshjeje kompetencash,

prandaj edhe kryetarët e komunave përkatëse, si organe ekzekutive të pushtetit vendor, në cilësinë e subjektit në konflikt, legjitimohen për t’iu drejtuar Gjykatës, *ratione personae*.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave paraqitet brenda 6 muajve nga data e lindjes së konfliktit. Gjykata vëren se vendimi 3/2013, i cili është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, është miratuar nga KKT-ja në datën 18.10.2013, kurse kërkesa është paraqitur në datën 28.01.2014, pra brenda afatit ligjor 6-mujor, prandaj kërkuesi ka edhe legjitimitim *ratione temporis*.

12. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata çmon të shprehet veçmas, përderisa nga subjektet e interesuara janë ngritur pretendime që kanë lidhje me juridiksionin e Gjykatës.

C. Për juridiksionin e Gjykatës në shqyrtimin e vendimit nr. 3/2013

13. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka ngritur edhe pretendimin për mungesën e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e vendimit të KKT-së, për shkak të karakterit të tij individual dhe jo normativ. Sipas këtij subjekti, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi vendimi 3/2013 është një akt me karakter individual dhe, si i tillë, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, sipas nenit 131/c të Kushtetutës.

14. Gjykata vëren se në shkronjën “c”, të nenit 131 të Kushtetutës është përcaktuar kompetenca e saj për të shqyrtuar pajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetueshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Prandaj, gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës, Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj mbi shqyrtimin substancial të aktit normativ.



15. Kompetenca e Gjykatës për të vendosur për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, është parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 131 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshjen. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, apo kur ligje të ndryshme u atribuojnë të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë atë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues in abstracto. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit (*shih vendimet nr. 26, datë 4.12.2006 dhe nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë mënyrë, vlerësimi i Gjykatës përqendrohet mbi mosmarrëveshjen në lidhje me kryerjen e funksioneve të nivelit kushtetues, për të cilin akti është thjesht (edhe pse i nevojshëm) një tregues. Gjykata zgjidh konfliktin që i nënshtrohet gjykimit të saj, duke deklaruar pushtetin të cilit i takojnë kompetencat në diskutim, çka është edhe qëllimi i këtij lloji kontrolli dhe kur është nxjerrë një akt i vesuar nga moskompetenca, e shfuqizon atë. Në çështje të tilla, ushtrimi i kësaj kompetence të Gjykatës nuk kufizohet nga natyra e aktit që është bërë shkak për lindjen e konfliktit, prandaj ai mund të jetë një akt çfarëdo me karakter ligjor e nënligjor ose edhe një akt formalisht dhe materialisht administrativ.

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar për mungesën

e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje është haptazi i pabazuar.

C. Për themelin e kërkesës

18. Kërkuesi pretendon lindjen e konfliktit për shkak se organi i qeverisjes qendrore, me anë të aktit që ka miratuar, ka ndërhyrë drejtpërdrejt në veprimtarinë e organeve të planifikimit urban, duke bllokuar vendimmarrjen lokale dhe veprimtarinë e njërive të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit. Një nga kërkuesit, komuna Kashar, pretendon se është penguar në ushtrimin e kompetencave, që kanë të bëjnë me dhënien e lejeve zhvillimore bazuar në planin e përgjithshëm vendor të kësaj komune. Sipas kërkuesit, i vetmi rast kur autoriteti i planifikimit në nivel kombëtar vendos pezullimin, është ai i parashikuar në nenin 32 të ligjit, por në këtë rast nuk janë respektuar kushtet ligjore, pasi: pezullimi nuk është vendosur gjatë nismës për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të çështjes; pezullimi i njihet si kompetencë AKPT-së dhe jo KKT-së dhe pezullimi i zhvillimit nuk është përdorur në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë.

19. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, argumenton se KKT-ja ka ushtruar të drejtën për vendimmarrje pezulluese për shkak të vlerësimit të ekzistencës së rrezikut të qartë ndaj vlerave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit apo të zonës, si një nga kushtet ligjore të marrjes së nismës për pezullimin e lejeve ndërtimore. Po sipas subjektit të interesuar, kjo vendimmarrje nuk është uzurpim kompetencash, por mbrojtje e interesit publik, sepse ka lidhje me emergjencën e ruajtjes dhe rehabilitimit të Kurorës së Tiranës. Gjithashtu, kjo ndërhyrje është proporcionale në raport me qëllimin që ka dashur të realizojë autoriteti i planifikimit kombëtar.

20. Gjykata rithekson se një mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet pushteteve mund të lindë kur një akt ose një sjellje, që konsiderohet e paligjshme, i sjell kërkuesit një dëm, sepse ndërhyr në sferën e kompetencave tërësisht ose pjesërisht të njohura atij. Pra, që të lindë një konflikt i tillë duhet të ketë një shkelje të sferës së kompetencave. Konflikti gjykohet i pranueshëm edhe kur, dhe pse nuk është kundërshtuar përkatësia e pushtetit, “përdorimi i



keq” që i është bërë atij pasqyron një zvogëlim të kompetencave të garantuara kushtetueshmërisht subjektit kërkues. Në një rast të tillë organi i cenuar nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se një akt i një organi tjetër ose sjellja mosvepruese e tij i kanë zvogëluar kompetencat apo e kanë penguar në ushtrimin e tyre.

21. Në rastin konkret, kërkuesi pretendon lindjen e konfliktit për shkak se organi i qeverisjes qendrore, me anë të aktit që ka miratuar, ka ndërhyrë drejtpërdrejt në veprimtarinë e organeve të planifikimit urban, duke bllokuar vendimmarrjen lokale dhe veprimtarinë e njësisve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit.

22. Gjykata ka theksuar se thelbi i nenit 13 të Kushtetutës janë parimet e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore, si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit “ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve.” Kurse autonomia është një regjim i tillë juridik, në të cilin organet e njësisve vendore veprojnë në pavarësi për zgjidhjen e atyre çështjeve që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë. Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e pushtetit vendor e shpreh

në ndarjen e kompetencave, e cila ka të bëjë me iniciativën që kanë ose duhet të kenë, në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se standardet e sipërpërmendura janë reflektuar në ligjin për planifikimin e territorit, i cili si një nga parimet kryesore për planifikimin e territorit ka përcaktuar bashkërendimin horizontal dhe vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit dhe palëve të interesuara, që garanton që instrumentet e planifikimit të miratohen në përputhje me instrumentet e planifikimit të miratuara nga autoritetet e tjera dhe që ato të harmonizojnë interesat publikë e privatë, kombëtarë e vendorë (*neni 4/b*). Më tej ligji përcakton se Plani i Përgjithshëm Kombëtar zbatohet në të gjithë territorin kombëtar. Hartimi dhe miratimi i tij mbështeten në planet kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale, në rastet kur këto janë miratuar më parë (*neni 26/2*). Objektivat e planifikimit kombëtar janë: (...) orientimi i objektivave për planifikimin ndërvendor e vendor (*neni 26/4/d*). Instrumentet vendore të planifikimit të territorit hartohen dhe miratohen në përputhje me instrumentet kombëtare të planifikimit të territorit, si dhe me instrumentet e planifikimit të njësisë kufizuese të qeverisjes vendore, për çështje të rëndësishme të përbashkët (*neni 27/2*).

24. Ligji i ka ndarë autoritetet e planifikimit të territorit në autoritete kombëtare dhe vendore, duke parashikuar edhe kompetencat e tyre. Sipas nenit 5 të ligjit, autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit janë Këshilli i Ministrave, KKT-ja, AKPT-ja, si dhe çdo organ publik qendror që ka detyra dhe përgjegjësi në planifikimin e territorit ose i janë deleguar detyra e përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit dhe kontrollin mjedisor. Këto autoritete ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga dhe/ose bazohen në legjisllacionin në fuqi për çështje të rëndësishme kombëtare të planifikimit të territorit. Sipas nenit 8 të ligjit, KKT-ja është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit. Për sa u përket autoriteteve vendore të planifikimit, neni 12 i ligjit parashikon se ato janë



bashkia/komuna, qarku dhe organet që janë në varësi të bashkisë/komunës/qarkut, të cilat ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në të gjithë territorin e tyre administrativ.

25. Përveç sa më sipër, ligji ka parashikuar edhe instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit, të cilat janë instrumente që miratohen e zbatohen nga autoritetet e planifikimit për të garantuar një interes publik. Një prej tyre është edhe pezullimi i zhvillimit, që nënkupton ndalimin e përkohshëm të zhvillimit ose shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimi, në të gjithë territorin ose në një pjesë të tij për një, disa ose çdo tip zhvillimi, në mënyrë që të ruhet territori në fjalë gjatë periudhës së hartimit të një instrumenti të planifikimit (*neni 3, pika 39/a*). Neni 63 i ligjit e ka përcaktuar pezullimin e zhvillimit si një ndër instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit në territor, të cilat zbatohen kur është i domosdoshëm realizimi i një qëllimi apo përdorimi publik i dokumentuar dhe kur rezulton të jetë metoda e vetme, e përshtatshme për realizimin e tij. Sipas nenit 64, pezullimi i zhvillimit përdoret, në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë, vetëm kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin një zgjidhje të përshtatshme. Autoriteti i planifikimit mund të vendosë pezullimin e zhvillimit gjatë miratimit të nismës për hartimin e instrumentit të planifikimit ose gjatë procesit të hartimit të tij.

26. Gjykata ka theksuar se vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston, midis të tjerave, në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të funksioneve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113 i Kushtetutës), dhe në ekzistencën e mjeteve financiare e të mjeteve të tjera, të cilat ajo i disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111 dhe 113, shkronjat “b”, “c”, “ç”, të Kushtetutës) (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, Gjykata ka konkluduar se planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit

për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore konsiderohet një masë që ndërhyr në ushtrimin e funksioneve të veta nga ana e autoriteteve vendore.

27. Gjykata ka theksuar se shumë çështje kanë implikime si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t'i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t'i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet t'i tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrjeje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës. Është e lejueshme që çështje me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit dhe që lidhen me miratimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike rajonale e më gjerë, të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre, sa që ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëhej e pandjeshme (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se e drejta e pezullimit të zhvillimit është një kompetencë që ligji ia ka njohur autoritetit përkatës të planifikimit, i cili mund të jetë ai kombëtar apo vendor, në varësi të instrumentit të planifikimit. Sipas nenit 32 të ligjit, KKT-ja, me propozimin e AKPT-së, përcakton një çështje si të rëndësishme kombëtare në planifikim dhe dispozita përcakton edhe procedurën që ndiqet



deri në miratimin e aktit, si dhe të drejtën e pezullimit, në bazë të nenit 64 të ligjit, në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj interesave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit apo të zonës, për të cilën propozohet përcaktimi si i rëndësishëm kombëtar në planifikim. Në këtë kuptim, në rastin konkret, KKT-ja, si një nga autoritetet kombëtare të planifikimit, ka vendosur pezullimin e lejeve të zhvillimit në zonën që është vlerësuar se paraqet rëndësi të veçantë në planifikim dhe zhvillim territori, sikundër është Kurora e gjelbër e Tiranës.

29. Për më tepër, Gjykata çmon se nga i gjithë konceptualizimi i ligjit për planifikimin e territorit, planet vendore duhet të kenë përshtatshmëri me Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Prandaj edhe kompetencat vendore ndërthuren me kompetencat kombëtare, me qëllim interesin e përgjithshëm të drejtimit të zhvillimit në rrafsh kombëtar. Planet rregulluese të territoreve vendore nuk mund të jenë të shkëputura nga politikat kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në këto kushte, pezullimi i dhënies të lejeve të ndërtimit, edhe pse organet vendore mund të kenë në dispozicion planet vendore, për shkak të hartimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar është masë dhe instrument i përkohshëm i lejuar nga ligji, pikërisht për harmonizimin dhe përshtatshmërinë e politikave kombëtare dhe vendore mes tyre. Vetë ky ligj urdhëron pezullimin e zhvillimit nëpërmjet një akti administrativ të nxjerrë nga autoritetet e planifikimit sipas formës dhe procedurës përkatëse ligjore, duke u respektuar dhe kufizimet në lidhje me qëllimin e miratimit të tij.

30. Nga analiza e sipërpërmendur, Gjykata vlerëson se përderisa organet qendrore, ashtu si dhe organet vendore kanë kompetenca të pezullimit të zhvillimit sipas kriterëve ligjore, nuk jemi para cenimit apo bllokimit të kësaj kompetence vendore me natyrë kushtetuese në fushën e planifikimit. Edhe pse pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore në komunat e përfshira në Kurorën e Tiranës sjell një pengesë të përkohshme në ushtrimin e funksioneve të organeve të qeverisjes vendore, kjo ndërhyrje është e justifikuar nga rëndësia e çështjes që rregullohet.

31. Po kështu, sipas kërkesës, vendimi 3/2013 është në kundërshtim me nenin 64 të ligjit për

planifikimin e territorit, pasi sipas këtij vendimi afati i pezullimit është i papërcaktuar, ndërkohë që ligji ka parashikuar një afat maksimal prej 12-muajsh.

32. Parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre dhe respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 17.2.2012 dhe nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata vëren se bazuar në nenin 64/4 të ligjit për planifikimin e territorit, pezullimi i zhvillimit mund të vendoset për një periudhë kohore deri në 12 muaj dhe ai mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, për shkaqe specifike të përligjura. Në këto kushte, për sa kohë që afati brenda të cilit mund të zbatohet një instrument i tillë kontrolli i territorit është parashikuar nga norma ligjore, fakti që ai nuk ka gjetur pasqyrim në vendimin nr. 3/2013, nuk e bën këtë akt të cenueshëm. Për sa më sipër, ky pretendim i kërkesës është i pabazuar.

34. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkesës, që lidhen me organin kompetent për miratimin e vendimit nr. 3/2013 ose me mosrespektimin e procedurës paraprake për miratimin e aktit, Gjykata vlerëson se janë pretendime të orientuara drejt paligjshmërisë së vendimit nr. 3/2013 dhe si të tilla nuk do të analizohen, pasi nuk janë pjesë e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Ato janë çështje që lidhen me ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e aktit të kundërshtuar dhe, si të tilla, hyjnë në juridiksionin gjyqësor administrativ.

35. Si konkluzion, Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura nga kërkesi janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131, shkronja



“ç”; 134, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 54, 55, 56 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës³.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 115, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”, 5, pika 1, germa “P”, 8, 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike

dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

³Gjyqtari S. Berberi votoi për rrëzimin e kërkesës për mungesën e juridiksionit kushtetues me argumentin se kërkuesi, në thelb, kërkon kontrollin e ligjshmërisë së aktit individual të kundërshtuar, për të cilin, kërkuesi mund t’i drejtohet juridiksionit administrativ gjyqësor.

**VENDIM****Nr. 116, datë 1.12.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“HIDROPOWER ELEKTRIK” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregut të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregut të energjisë elektrike:

- Neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c” është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit

të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregut të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 117, datë 1.12.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“HIDROPOWER ELEKTRIK” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe neni 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 8, 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, neni 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,



konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.9, gerrat “a”, “b” dhe “c”, janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 118, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të

ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Neni 9, pika 4/10, gerrat “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 119, datë 1.12.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË “NOA
ENERGY TRADE” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 120, datë 1.12.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË “NOA
ENERGY TRADE” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9, 13, pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4, dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e



paraqitur nga shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit: është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

-Neni 9, pika 4/9, germet “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 121, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FATLUM” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PERROLLAJ”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, neni 9 dhe neni 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “a”, dhe neni 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, neni 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1,

Formati i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, 4.1.3) janë plotësuar në mënyrë korrekte. (Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.1.3 është plotësuar korrekt.

- Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik është plotësuar pjesërisht.

(Mungon plani i biznesit.)



- Leje nga institucione të tjera. (Neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Perrollaj”, fuqia e instaluar 0,5 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 122, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “FATLUM” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson plotësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar korrekt.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 123, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “FATLUM” SHPK PËR HEC “PERROLLAJ” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”; 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit



3, pika 1, germa “P”; të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për HEC-in “Perrollaj” me fuqi të instaluar totale 0,5 MW, si burim i rinovueshem energjie.

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”
Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për kualifikim impianti prodhues për HEC “Perrollaj”, si burim i rinovueshem energjie me fuqi të instaluar 05 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 124, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “CEREMI” DHE “DRAGOBIA”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

(Mungon struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave).

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, 4.1.3) janë plotësuar pjesërisht. (Janë pa plotësuar të dhenat teknike për HEC-et nga aplikuesi. Janë pa plotësuar të dhënat teknike për bllokun e transformimit nga aplikuesi.)

- Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.1.3 është plotësuar korrekt.

- Neni 9, pika 4.1.4, dokumentacioni tekniko-ekonomik është plotësuar pjesërisht.

(Mungojnë studimi i fizibilitetit, grafiku i zbatimit të projektit dhe plani i biznesit.)

- Leje nga institucione të tjera. (Neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar korrekt.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Ceremi” dhe “Dragobia”, me fuqi të instaluar “Ceremi” 8.6 MW dhe “Dragobia” 13.4, me fuqi totale 22 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 125, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f” 8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm.

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit: është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.



(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Neni 9, pika 4/9, germat “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 126, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “FUTURE ENERGY AL” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Future Energy AL” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së

Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Future Energy AL” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

Mungon vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata që personi nuk është i përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Future Energy AL” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 127, datë 1.12.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“FUTURE ENERGY AL” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9; 13, pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f” 8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Future Energy AL” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Future Energy AL” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit: është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon, vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata që personi nuk është i përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Neni 9, pika 4/9, germet “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Future Energy AL” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 128, datë 1.12.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“AXPO ALBANIA” SHA, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AXPO Albania” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike



dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germa “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AXPO Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 129, datë 3.12.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të

miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1, formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2, dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave)

- Neni 9, pika 4/10, është i plotësuar pjesërisht. (Nuk është dhënë sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.)

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” (mungon deklarimi i kapitalit financiar i vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti).

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM
Nr. 130, datë 3.12.2014**

**MBI PROCEDURAT PËR BLERJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
MBULIMIN E HUMBJEVE NË
SISTEMIN E SHPËRNDARJES NGA
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
(OSHEE SHA)**

Në mbështetje të neneve; 8, pika 2, germa “P”; dhe 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 98, datë 27.10.2014, “Për përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi procedurat për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.),

konstatoi se,

- Me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ERE licenoi në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.) për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, ERE licenoi në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të Energjisë Elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.)

- Me vendimin nr. 98, datë 27.10.2014, ERE

vendosi përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 21.1.2013.

Në bazë të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcakton procedurat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike në përputhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 30, datë 23.3.2011, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a.”.

2. Ky vendim është objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1107, datë 24.11.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Klement Metushi, i datëlindjes 6.12.1975.

KËRKESË

Shtetasi Përparim Beqari kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të vdekur të shtetasit Lefter Beqari, i datëlindjes 30.3.1968.

**KËRKUESI
Përparim Beqari**

**Korrigjim gabimi**

Në udhëzimin nr. 364, datë 16.12.2014, “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 196, datë 26 dhjetor 2014, faqe 11006, në pikën 18 të udhëzimit **data 13.5.2015 bëhet 11.5.2015;**

dhe në pikën 19 të udhëzimit, data **18.5.2015, bëhet data 16.5.2015.**

Korrigjim gabimi

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.602, datë 10.9.2014 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet””, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, faqe 6610, në pikën 3 të tij bëhet korrigjimi:

Ishte: 3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe **katër** anëtarë;

Bëhet: 3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe **pesë** anëtarë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 32 lekë